



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në mbështetje të nenit 150 dhe 152 të Statutit të OAK-së, nenit 7, 9, 29 dhe 34 të Rregullores për Stafin e OAK-së, dhe neni 4 të Udhëzimit Administrativ; NR: 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Këshilli Drejtues i OAK-së, shpallë:

K O N K U R S
për vend të lirë të punës

Pozita: Koordinator i Qendrës Trajnuese për Avokatë
Koeficienti: 10

I. Kushtet:

Përveç kushteve themelore për krijimin e marrëdhënies së punës, kandidati duhet të ketë:

1. Fakultetin Juridik (katërvjeçar ose bachelor + master)
2. 3 vjet përvojë punë në pozita të ngjashme
3. Të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës
4. Njohja e punës me kompjuter (Programet e Windows-it) e obligueshme
5. Njohja e gjuhëve zyrtare (njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme)

Tek kandidatët do të vlerësohet: afiniteteti, kreativiteti, shkathtësitë profesionale, aftësia për të përballuar punën nën presion.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

1. Koordinator i Qendrës Trajnuese menaxhon dhe koordinon aktivitetet e Qendrës.
2. Zbaton vendimet e Këshillit;
3. Zbaton programet trajnuese të Qendrës;
4. Përfaqëson Qendrën Trajnuese para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
5. Propozon projekt buxhetin vjetor të Qendrës;
6. Merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues të OAK-së dhe Këshillit Drejtues të Qendrës Trajnuese;
7. Mbikëqyrë punonjësit e Qendrës;
8. Përgatitë raporte të rregullta vjetore dhe raporte tjera sipas kërkesës së Këshillit;
9. Angazhohet për gjetjen e fondeve shtesë për projektet e qendrës.
10. Kujdeset për shpenzimet financiare lidhur me realizimin e buxhetit të qendrës
11. Kujdeset për fajlliminin e dokumentacionit i cili ka të bëjë me realizimin e aktiviteteve të qendrës
12. Kryen edhe punët e tjera në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Qendrës dhe sipas udhëzimeve të Drejtorit Ekzekutiv.

KOHËZGJATJA E PUNËSIMIT:

Punësimi është me afat të pacaktuar, pas përfundimit me sukses të periudhës provuese prej 6 (gashtë) muaj.

DATA E MBYLLJES SË KONKURSIT:

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë prej ditës së shpalljes në gazetë lokale, në tabelën e shpalljeve të OAK-së dhe në web faqen e Odës së Avokatëve të Kosovës: www.oak-ks.org.

PARAQITJA E APLIKACIONIT:

Aplikacionet merren në web faqe të OAK-së dhe dorëzohen në zyrat e Odës së Avokatëve të Kosovës, Rr. "Bekim Fehmiu p.n.", Kati IV, Prishtinë.

Aplikacionit i bashkangjiten: CV; një letër motivuese, dy referenca, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kandidatët të cilën hynë në listën e ngushtë, për testim dhe intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit.

Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, rr.Bekim Fehmiu p.n, Kati IV, ose nëpërmjet e-mailit: info@oak-ks.org

Për informata më të hollësishme të interesuarit mund të na drejtohen me anë të E-mail adresën: info@oak-ks.org ose në numrat e telefonit: +383 38/610 101, çdo ditë pune prej orës 08:00 – 16:00.

Kërkesat e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.